



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR
ZYRA E STREHIMIT

PROJEKT -VENDIM - nr. 6

PËR

“PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E VLERËS SË QIRASË PËR VITIN 2024-2025, TË FAMILJEVE TË CILAT JANË STREHUAR NË BANESËN SOCIALE”

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” gërma f) ku thuhet se: “vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi”, ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, datë 22.6.2023, VKB nr.57 datë 25.08.2021 “Për zhvendosjen e familjeve dhe strehimit të tyre në mesin e Ish Laboratorit Qëndror, ndarjen e apartamenteve dhe përcaktimin e qirasë mujore” si dhe VKB nr.58 datë 25.08.2021 “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e Banesave Sociale me qira pranë Ish Kombinatit të Sheqerit Maliq”, Këshillit të Bashkisë i

PROPOZOJMË

1. Të miratojë përjashtimin nga pagesa e qirasë sociale, për vitin 2024-2025, familjet e strehuara në BSQ ish Laboratori, sipas tabelës Nr.1 bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror.

Ky përjashtim bëhet në kuadër të vazhdimësisë së mbështetjes nga Bashkia për këto familje, me qëllim fuqizimin ekonomik të tyre si dhe duke i stimuluar ato që të angazhohen në mirëmbajtjen e zakonshme dhe pastrimin e BSQ-së.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

Konceptoi

Miratoi Përgjegjës i Sektorit

(Emër Mbiemër)

L.Mullalli

E.Petriti

Nenshkrimi

Data

Dt 16/02/2024

Dt. 16/02/2024

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU




Tabela Nr.1 Llogaritja e qirasë sipas familjeve.

Nr. Ap.	Emër, atësia, mbiemër	Qiraja që duhet të paguajë familja për vitin 2024-2025
1	Dorjan Hysen Terolli	0
2	Edmond Haxhi Pero	0
3	Esat Riza Marjanaku	0
4	Piro Astrit Mete	0
5	Françesko Astrit Mete	0
6	Shpëtim Selim Sulejmani	0
8	Erion Nazmi Rexha	0
9	Natasha Adem Stoceni	0


Konceptoi
Miratoi Përgjegjës i Sektorit

(Emër Mbiemër)
L.Mullalli
E.Petriti

Nenshkrimi

Data
Dt. 16/02/2024
Dt. 16/02/2024

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim ҲOPÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR
SEKTORI I SHËRBIMEVE SHOQËRORE DHE STREHIMIT

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN
PËR

“PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E VLERËS SË QIRASË PËR VITIN 2024-2025, TË FAMILJEVE TË CILAT JANË STREHUAR NË BANESËN SOCIALE”

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” gërma f) ku thuhet se: “vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi”, ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, datë 22.6.2023, VKB nr.57 datë 25.08.2021 “Për zhvendosjen e familjeve dhe strehimin e tyre në godinën e Ish Laboratorit Qëndror, ndarjen e apartamenteve dhe përcaktimin e qirasë mujore” si dhe VKB nr.58 datë 25.08.2021 “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e Banesave Sociale me qira pranë Ish Kombinatit të Sheqerit Maliq”.

Bashkia Maliq në fund të vitit 2021 ka strehuar 9 familje pranë Banesës Sociale në godinën e Ish Laboratorit, pranë Kombinatit të Sheqerit Maliq. Këto familje i përkasin kryesisht minoritetit Rom dhe Egjiptjan. Të ardhurat e tyre janë minimale dhe të pa qëndrueshme, disa prej tyre janë pa asnjë të ardhur me probleme social-ekonomike dhe shëndetësore. Gjatë vitit 2022 një pjesë prej këtyre familjeve kanë paguar një qira minimale, vlerë e cila nuk ndikon në shtimin e të ardhurave të bashkisë pasi është e pa konsiderueshme, ndërsa familjet pa të ardhura bazuar ligjit 22/2018 i ndryshuar nuk paguajnë qira. Në bazë të ligjit 22/2018 i ndryshuar të ardhurat nga qiraja e BSQ duhet të shkojnë për mirëmbajtjen e saj dhe jo si e ardhura për buxhetin e bashkisë. Gjatë vitit 2022-2023 Këshilli bashkiak Maliq ka falur qiranë për këto familje me qëllim vazhdimin e mbështetjes social ekonomike të tyre, duke nxitur familjet që mirëmbajtjen e zakonshme të BSQ ta kryejnë vetë. Familjet duke e vlerësuar mbështetjen e bashkisë janë angazhuar në mirëmbajtjen dhe pastrimin e objektit dhe aktualisht gjëndja e BSQ është në kushte dhe pastërti optimale. Duke marrë në konsiderate situatën e rritjes së kostos së jetesës nga rritja e çmimeve dhe gjëndjen e vështirë ekonomike të tyre si dhe vlerësuar angazhimin e tyre për mirëmbajtjen dhe pastrimin e objektit propozojmë përjashtimin nga pagesa e sociale edhe për vitet 2024-2025 me qëllim vazhdimin e mbështetjes së mbështetjes së tyre dhe duke i nxitur për dhënien e kontributit në mirëmbajtjen dhe pastrimin e ambjentëve të banesës Sociale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj.

Konceptoi

Miratoi Përgjegjës i Sektorit

(Emër Mbiemër)

L.Mullalli

E.Petriti

Nënshkrimi

Data

Dt. 16/02/2024

Dt. 16/02/2024

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU